

MARRËVESHJE AUDITIMI

**AUDITIM I PËRBASHKËT I PERFORMANCËS
BARAZIA GJINORE DHE FUQIZIMI I GRAVE NGA ZONAT RURALE
PËRMES PËRFSHIRJES SË TYRE NË TREGUN E PUNËS**

NDËRMJET PËRFAQËSUESVE TË

**ENTIT SHTETËROR TË REVIZIONIT TË REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË SË VERIUT**

dhe

KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT TË SHQIPËRISË

dhe

ZYRËS KOMBËTARE TË AUDITIMIT NË KOSOVË

Shkup, Mars 2023

Hyrje

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet përfaqësuesve të Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kontrollit të Lartë të Shtetit të Shqipërisë, dhe Zyrës Kombëtare të Auditimit në Kosovë më poshtë referuar si "palët kontraktuese"

Parimet e Përgjithshme

Kjo Marrëveshje bazohet në rregulloret ligjore për funksionimin e institucioneve supreme të auditimit (SAI) nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje dhe Deklaratat Profesionale të INTOSAI-t.

Përmbajtja dhe Struktura e Marrëveshjes janë në përputhje me Udhëzuesin 9000 të INTOSAI-t.

Tema e propozuar e auditimit të performancës ka lidhje të drejtpërdrejtë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim të Qëndrueshëm. Agjenda 2030 siguron një kuadër universal për forcimin e veprimit kolektiv lidhur me synimet dhe sfidat e përbashkëta për prosperitetin e të gjithëve dhe përmbushjen e përgjegjësive tona ndërbrezore, të cilat mund të arrihen vetëm përmes partneriteteve bashkëpunuese që përfshijnë të gjitha vendet dhe të gjitha palët e interesit. Barazia gjinore është një prej temave qendrore të Agjendës 2030. Ajo thekson se "arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave dhe vajzave do të japë kontribut me rëndësi për të gjitha synimet dhe detyrat", dhe thekson për përfshirjen sistematike të pikëpamjes gjinore në zbatimin e përgjithshëm.

Megjithëse, barazia gjinore konsiderohet si një çështje horizontale që duhet trajtuar gjatë realizimit të OZHQ-ve në përgjithësi, është parashikuar edhe një Objektiv i veçantë, paraqitur në nenin 5 dhe që synon barazinë gjinore në veçanti. Ky objektiv synon të fuqizojë gratë dhe vajzat dhe të realizojë potencialin e tyre të plotë, që në mënyrë të paevitueshme nënkupton eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit bazuar në seks, dhe dhunës me bazë gjinore. Për më tepër, Objektiv i paraqitur në nenin 5 synon të sigurojë qasje universale në shëndet seksual dhe riprodhues dhe në të drejtat e riprodhimit, të pranojë vlerën e kujdesit dhe punës shtëpiake të papaguar dhe të pjesëmarrjes krahas burrave në jetën politike, ekonomike dhe publike.

Neni 1

Titulli i Auditimit

Palët kontraktuese kanë rënë dakord të bashkëpunojnë për kryerjen e auditimit paralel të performancës "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes në tregun e punës".

Neni 2

Qëllimi i Auditimit

Palët kontraktuese kanë rënë dakord të kryejnë këtë auditim për barazinë gjinore për të verifikuar nëse ka politika dhe masa në zbatim për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës.

Qëllimi i auditimit do të përfshijë politikën dhe masat e hartuara për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës. Objektivi mund të ndryshojë në varësi të kompetencave të SAI-ve individuale.

Neni 3

Lloji i Auditimit

Bashkëpunimi ndërmjet palëve kontraktuese do të jetë në formën e një auditimi paralel.

Me përfundimin e auditimit, secila palë kontraktuese do të hartojë një raport kombëtar auditimi. Palët kontraktuese do të shkëmbejnë tekstet e raporteve kombëtare të auditimit në përputhje me dispozitat përkatëse ligjore që rregullojnë punën e tyre. Këto raporte kombëtare me përmbledhje të shkurtra shërbejnë si bazë për hartimin e raportit përfundimtar të përbashkët të auditimit për rezultatet e auditimit.

Rezultatet e auditimit do të paraqiten në një raport të përbashkët auditimi.

Ekipet kombëtare të auditimit të SAI-ve pjesëmarrës do të kryejnë auditimet kombëtare.

Auditimi do të përqendrohet në rishikimin/verifikimin e efikasitetit dhe efektshmërisë së politikave dhe masave për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës, pra "A janë hartuar politika dhe masa për përfshirjen e grave nga zonat rurale në tregun e punës?"

Neni 4

Natyra e Auditimit

Auditimi do të organizohet si auditim performance sipas përshkrimit në Standardet e Auditimit të INTOSAI-it.

Neni 5

Objektivi/at e Auditimit

Objektivi i auditimit është të vlerësojmë efektshmërinë e masave për përfshirjen grave nga zonat rurale në tregun e punës duke iu përgjigjur pyetjeve/fushave paraprake të auditimit të përcaktuara në parastudim.

Auditimi do të japë rekomandime për përmirësimin e kushteve në fushën e caktuar të auditimit.

Neni 6

Periudha e Auditimit

Auditimi do të mbulojë periudhën 2019 - 2023, megjithëse edhe disa rrethana përpara kësaj periudhe mund të auditohen për të mbledhur të dhëna për kryerjen e analizave krahasuese dhe për analizimin e disa operacioneve (të ardhura, shpenzime, struktura e të ardhurave dhe shpenzimeve, investimet kapitale, etj.).

Neni 7

Metodologjia

Auditimi do të kryhet në përputhje me Deklaratat Profesionale të INTOSAI-t, dhe në veçanti:

- Udhëzimi 9000 i INTOSAI-t, Auditimet në Bashkëpunim mes SAI-ve;
- ISSAI 300 - Parimet e Auditimit të Performancës;
- ISSAI 3000 - Standardi i Auditimit të Performancës, dhe
- standardet kombëtare ose udhëzimet e auditimit.

Neni 8

Shtirja e Auditimit

Palët kontraktuese do të zbatojnë auditime kombëtare për aq sa është në përputhje me objektivat e përcaktuar në Nenin 5 të këtij dokumenti dhe sipas planeve të auditimit dhe programeve të SAI-ve pjesëmarrës.

Palët kontraktuese mund të vendosin:

- të kufizojnë shtirjen e auditimit të paraqitur në një program auditimi për shkak të rrethanave të veçanta,

- të zgjerojnë shtrirjen e auditimit në nivel kombëtar.

Neni 9

Koordinatori i Auditimit

Zyra Shtetërore e Auditimit të Republikës së Maqedonisë së Veriut do të jetë koordinatori i aktiviteteve të auditimit, mbledhjeve të punës, si dhe përgatitjes së Raportit të Përbashkët të Auditimit.

Neni 10

Ekipe të Auditimit

Për qëllimin e këtij bashkëpunimi do të formohet një ekip ekspertësh, i përbërë nga përfaqësuesit e mëposhtëm të palëve kontraktuese:

Entit Shtetëror të Revizionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Koordinator Projekti:

- Znj. Tatjana Dimitrovska, Zëvendës Audituese e Përgjithshme
- Z. Gorast Nikoloski, Zëvendës Drejtues i Auditimit, Drejtues Ekipi
- Znj. Sanja Goceva, Audituese e Lartë, Pjesëtare Ekipi.

Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë:

- Z. Alfred Zylfi, Drejtor Drejtorie i Auditimit të Performancës
- Znj. Ermira Vojka, Audituese e Lartë, Drejtuese Ekipi
- Znj. Arminda Bushi, Audituese e Lartë, Pjesëtare Ekipi
- Znj. Jorida Zhegu, Audituese, Pjesëtare Ekipi.

Zyra Kombëtare e Auditimit e Kosovës:

- Znj. Myrvete Gashi, Ndihmës Auditore e Përgjithshme
- Znj. Ariana Gjonbalaj, Drejtor i Departamentit të Performancës
- Znj. Ardiana Miftari, Udhëheqëse e ekipit
- Znj. Ylfete Osmani, Anëtare e ekipit
- Znj. Arlinda Mustafa, Anëtare e ekipit.

Neni 11

Afatet

- Mars 2023 – Takimi fillestar i organizuar nga Koordinatorit i Auditimit;
- Mars 2023 – Fillimi i auditimeve kombëtare;
- Maj - dhjetor 2023 – Takime pune për fazën e planifikimit/zhvillimit/raportimit;
- Janar 2024 - Finalizimi i raporteve kombëtare të auditimit dhe përmbledhjet e shkurtra të cilat i dorëzohen Koordinatorit të Auditimit;
- Shkurt - mars 2024 - përgatitja e raportit të përbashkët të auditimit dhe dakordsimi ndërmjet palëve bashkëpunuese;
- Prill 2024 - publikimi i Raportit të Përbashkët të Auditimit.

Neni 12

Shkëmbimi i Informacionit

Shkëmbimi i informacionit lidhur me auditimin ndërmjet palëve kontraktuese, duke përfshirë takimet dhe konsultimet e ardhshme, do të bëhet në mbledhjet e ekipit të ekspertëve dhe/ose përmes korrespondencës elektronike.

Neni 13

Konfidencialiteti

Të gjithë audituesit duhet të respektojnë konfidencialitetin e informacionit të përftuar gjatë kryerjes së shërbimeve profesionale dhe nuk duhet të përdorin ose të bëjnë publik asnjë informacion të tillë pa autoritetin e duhur dhe përkatës, përveç rasteve kur ekzistojnë të drejta ose detyrime ligjore ose profesionale për të vepruar ndryshe.

Neni 14

Gjuha e Bashkëpunimit

Dokumentet e hartuara në kuadër të këtij bashkëpunimi që do të ndahen ndërmjet palëve bashkëpunuese do të përgatiten në gjuhën angleze.

Neni 15

Raportimi në organet kombëtare

Palët kontraktuese kanë lirinë të vendosin nëse dhe në cilën formë ia komunikojnë rezultatet e auditimit të koordinuar organeve përkatëse kombëtare.

Neni 16

Kostot e Auditimit

Agjencia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave (UN Women) do të ofrojë mbështetje për nënshkruarit e Marrëveshjes lidhur me zbatimin e veprimtarive të projektit të rëna dakord si më poshtë:

- organizimin e aktivitetit për nënshkrimin e Marrëveshjes,
- organizimin e të paktën tre mbledhjeve ndërmjet SAI-ve gjatë zbatimit të auditimit paralel, dhe mbulimin e udhëtimit, shpenzimeve ditore dhe të fjetjes për delegacionet e SAI-ve,
- organizimin e mbledhjeve të tjera online,
- shërbimet e interpretimit dhe përkthimit për nevojat e auditimit,
- punësimin e ekspertëve ndërkombëtarë të fushës, dhe
- hartimin dhe printimin (publikimin) e Raportit të Përbashkët të Auditimit.

Neni 17

Buxheti i Auditimit

Palët kontraktuese bien dakord të mos miratojnë një buxhet të përbashkët për auditimin paralel. Buxheti i auditimit dhe burimet e tjera të nevojshme për zbatimin e auditimit do të përcaktohen nga secila palë nënshkruese e kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi.

Neni 18

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi i kësaj marrëveshjeje bashkëpunimi zgjidhet nga palët kontraktuese me konsultim.

Neni 19

Modifikimet dhe Ndryshimet e Marrëveshjes

Në rast se palët kontraktuese kanë për qëllim të modifikojnë apo ndryshojnë këtë Marrëveshje, palët e tjera kontraktuese duhet të njoftohen. Të gjitha ndryshimet koordinohen dhe përcaktohen në një shtojcë të Marrëveshjes.

Neni 20

Dispozitat e Fundit

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

Kjo Marrëveshje nënshkruhet në tre kopje identike në maqedonisht, shqip dhe anglisht, me tekst të barabartë dhe identik. Në rast mospërputhjeje në dispozitat e Marrëveshjes së Bashkëpunimit, varianti në anglisht është varianti mbizotërues dhe detyrues.

Shkup, 03. Mars 2023

Enti Shtetëror i Revizionit i Republikës së Maqedonisë së Veriut

e përfaqësuar nga

m-r Maksim Acevski

Auditues i Përgjithshëm

Nr. 03-443/2

Datë: 03.03.2023



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT
STATE AUDIT OFFICE

Kontrolli i Lartë i Shtetit i Shqipërisë

i përfaqësuar nga

Valbona Gaxha

Sekretare e Përgjithshme

Nr. 583/5

Datë: 03.03.2023



KONTROLLI I LARTË I
SHTETIT

Zyra Kombëtare e Auditimit në Kosovë


e përfaqësuar nga

Vlora Spanca

Auditore e Përgjithshme

Nr. 294/01

Datë: 03.03.2023



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE